

## VENDIM

Nr.52, date 29.1.2004

### PER PROCEDUREN E DHENIES SE PERDORIMIT CIVIL TE LENDEVE PLASESE

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te pikës 1 te nenit 9 te ligjit nr.9126, date 29.7.2003 "Për përdorimin civil te lendeve plasëse ne Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit te Industrisë dhe te Energjetikes, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Leja e përdorimit civil te lendeve plasëse nga personat fizike e juridike, private ose publike, vendas ose te huaj, jepet nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikes.
2. Leja e përdorimit civil te lendeve plasëse jepet për subjektet e licencuara nga institucionet përkatëse ne fushat minerare, gjeologjike, te hidrokarbureve dhe te ndërtimit, te cilat, për realizimin e veprimtarisë se tyre, kane domosdoshmëri përdorimin e lendeve plasëse.
3. Subjekti i interesuar, qe kërkon te pajiset me leje për përdorimin civil te lendeve plasëse duhet te plotësojë këto kriteret dhe kushte:
  - Te jete regjistruar ne gjykate si person juridik ose fizik;
  - Te këtë vërtetim nga organi i pushtetit vendor te zonës ku do te përdoren lendet plasëse, se ne atë zone ku do te ushtrohet veprimtaria me lende plasëse nuk ka objekte, qe rrezikohen nga përdorimi i tyre;
  - Te këtë lejen për ushtrimin e veprimtarisë, sipas pikës 2 te këtij vendimi;
  - Te këtë hartën topografike te zonës ne shkallen 1 :25000 dhe planimetrinë e zhvillimit te punimeve, me koordinatat e objektit ku do re përdoren lendet plasëse;
  - Te këtë te përcaktuara llojin, sasinë dhe karakteristikat fiziko-kimike te lendeve plasëse;
  - Te këtë llogaritjen e zonës se rrezikshme dhe pasaportën teknike te punës me lendet plasëse;
  - Te siguroje masat e sigurisë ne pune, ne përputhje me rregulloren e teknikes se sigurimit për pune me lendet plasëse;
  - Te këtë miratimin për depon e lendeve plasëse nga komisarati i policisë, qe mbulon territorin ku kërkohet leja ose kontrata me një subjekt qe zotëron depo te miratuar nga ky komisarati;
  - Te këtë kontratën e punës me drejtuesin teknik, inxhinier ose teknik miniere, inxhinier gjeolog, inxhinier ndërtimi, si dhe një fotokopje te noterizuar te diplomës;
  - Te këtë kontratën e punës me zjarrmëtarin dhe fotokopjen e noterizuar te dëshmisë se zjarrmëtarit;
  - Te këtë vërtetimin e regjistrimit te subjektit ne RISHM (reparti i inspektim-shpëtim miniera);
  - Te këtë programin vjetor te kualifikimit te punonjësve, qe merren me kryerjen e punimeve me lendet plasëse.
4. Subjektet, për t'u pajisur me leje sipas këtij vendimi, duhet te paraqesin kërkesën me shkrim ku te shënohen:
  - emri, mbiemri i kërkuesit dhe akti ligjor i përfaqësimit si person juridik ose fizik;
  - adresa e sakte e personit juridik ose fizik (tel/fax, celular);
  - veprimtaria qe do te kryeje personi fizik ose juridik me lendet plasëse.
5. Leja e përdorimit civil te lendeve plasëse jepet brenda 30 ditëve nga data e aplikimit me shkrim te kërkuesit. Kur nuk plotësohen te gjitha kërkesat e pikës 3 te këtij vendimi, kërkesa refuzohet me shkrim.

6. Afati i lejes për përdorim civil të lendeve plasëse është i njëjtë me afatin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë në fushat e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi dhe kur nuk ka sanksione për heqjen e lejes ripërtërihet së bashku me përtëritjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë.

7. Leja hiqet në rastet kur:

- subjekti, gjatë përdorimit civil të lendeve plasëse, nuk plotëson rregullat teknike të përdorimit dhe rrezikon jetën e njerëzve, të kafshëve ose vlerave materiale;
- subjekti kryen vepra penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së përdorimit të lendeve plasëse.

8. Marrësi i lejes së përdorimit civil të lendeve plasëse është i detyruar të kryejë punime brenda objektit për të cilin i jepet leja. Leja e dhënë nuk mund t'u transferohet personave të tjerë.

9. Personat e pajisur me leje të përdorimit civil të lendeve plasëse janë të detyruar të zbatojnë rregullat dhe masat teknike, të miratuara në rregulloren përkatëse.

10. Kontrolli i përdorimit civil të lendeve plasëse bëhet nga reparti i inspektim-shpëtim miniera (RISHM) dhe organet e specializuara shtetërore, të parashikuara me ligj.

11. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

Fatos Nano